



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 106

Tiranë – E hënë, 17 korrik 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 60/2023, datë 13.7.2023	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e ministrit të Brendshëm 11063
Vendim i Kuvendit nr. 61/2023, datë 13.7.2023	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Brendshëm 11063
Vendim i Kuvendit nr. 63/2023, datë 14.7.2023	Për kërkesën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Tiranë, “Për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Arben Ahmetaj” 11063
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 10.7.2023	Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar..... 11064
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 385, datë 29.6.2023	Për delegim kompetencash..... 11071
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 399, datë 6.7.2023	Për miratimin e rekomandimit GFCM/45/2022/11, “Mbi standardet minimale për menaxhimin e zonave të kufizuara të peshkimit”..... 11071
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 447, datë 10.7.2023	Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbaues Gjyqësor Shtetëror..... 11076
	Korrigjim gabimi në urdhrin e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 739, datë 15.12.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë’”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë. 11.1.2023..... 11076

**VENDIM
Nr. 60/2023****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIMIN E MINISTRI TË
BRENDSHËM**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 113, datë 10.7.2023, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 113, datë 10.7.2023, për shkarkimin e zotit Bledar Çuçi nga detyra e ministrit të Brendshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

**VENDIM
Nr. 61/2023****PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR EMËRIMIN E MINISTRI TË
TË BRENDSHËM**

Në mbështetje të nenit 98 të Kushtetutës dhe të dekretit nr. 114, datë 10.7.2023, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 114, datë 10.7.2023, për emërimin e zotit Taulant Balla në detyrën e ministrit të Brendshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

**VENDIM
Nr. 63/2023****PËR KËRKESËN E PROKURORISË SË
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR,
TIRANË, “PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT PËR ARRESTIMIN/
HEQJEN E LIRISË DHE USHTRIMIN E
KONTROLLIT PERSONAL/TË BANESËS
SË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, ZOTIT ARBEN AHMETAJ”**

Në mbështetje të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandim të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Tiranë, për dhënie autorizimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për arrestimin/heqjen e lirisë dhe ushtrimin e kontrollit personal/të banesës së deputetit Arben Ahmetaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 14.7.2023.

**UDHËZIM****Nr. 14, datë 10.7.2023****PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR
KLASË DHE NGARKESËN MËSIMORE
TË PUNONJËSVE ARSIMORË NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të shkronjës d të pikës 2 të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Numri i nxënësve për klasë dhe ngarkesa mësimore e punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar të jenë:

I. ARSIMI PARASHKOLLOR

1. Numri i nxënësve në grup/klasë përgatitore:

a) Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet me ushqim në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës që frekuentojnë.

b) Grupet e veçanta të nxënësve në kopshtet e zonave rurale të formohen me jo më pak se 15 nxënës që frekuentojnë.

c) Grupet e përziera të nxënësve në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës që frekuentojnë. Në rastet kur ky numër nxënësish nuk sigurohet, mund të formohet grup me jo më pak se 5 nxënës që frekuentojnë kopshtet, pas mendimit pozitiv të njëjësive të vetqeverisjes vendore.

d) Klasat përgatitore funksionojnë në kopshte ose shkolla të arsimit bazë dhe frekuentohen nga nxënës 5 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor. Klasa përgatitore në zonat urbane të formohet me jo më pak se 25 nxënës, ndërsa në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.

2. Numri i drejtuesve në arsimin parashkollor:

a) Kopshtet me ushqim ose pa ushqim që kanë të paktën 4 grupe të veçanta ose të përziera, të kenë një drejtues të institucionit arsimor.

b) Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kopshtet që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë pranë shkollave 9-vjeçare, mund të emërojnë një drejtues kopshti për jo më pak se 5 grupe nxënësish.

3. Ngarkesa mësimore javore e drejtuesve dhe e mësuesve në arsimin parashkollor:

a) Drejtori i kopshtit 18 orë në javë.

b) Drejtori i kopshtit i përcaktuar në pikën 2/b të këtij kreu 15 orë në javë.

c) Mësuesi i arsimit parashkollor 30 orë në javë.

4. Ngarkesa për procesin e vlerësimit:

Drejtori i kopshtit 6 orë në javë.

II. ARSIMI BAZË

1. Numri i nxënësve për klasë dhe ndarja e klasave

a) Klasat e veçanta në zonat urbane të formohen me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës.

b) Ndarja e klasave në paralele të bëhet sipas këtij rregulli:

i. dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30–59;

ii. tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60–99;

iii. katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100–133;

iv. pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134–167.

c) Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele bëhet për çdo rritje të numrit me 33 nxënës.

d) Numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor të llogaritet një mësues për çdo klasë. Lëndët TIK, Gjuhë e huaj dhe Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti (1 orë) do të zhvillohen nga punonjësit mësimorë të arsimit të mesëm të ulët, sipas profilit përkatës.

e) Në shkollat speciale klasat formohen me jo më pak se 4 nxënës; dy klasa paralele me 11–15 nxënës, tri klasa paralele me mbi 15 nxënës.

2. Formimi i klasave të bashkuara

Në institucionet arsimore, kur nuk plotësohet numri i nxënësve në përputhje me pikën A/1, të kreut II, të këtij udhëzimi, mësimi të organizohet me klasa të bashkuara. Numri i klasave të bashkuara përcaktohet sipas këtij rregulli:

a) Në arsimin fillor (klasat I–V):

i. një klasë, kur numri i nxënësve në klasat I–V është deri në 10;

ii. dy klasa, kur numri i nxënësve është 11–20;

iii. tri klasa, kur numri i nxënësve është 21–50.



iv. Klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave I–V është mbi 50, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.

b) Në arsimin e mesëm të ulët (klasat VI–IX):

i. një klasë, kur numri i nxënësve në klasat VI–IX është deri në 10;

ii. dy klasa, kur numri i nxënësve është 11–20;

iii. tri klasa, kur numri i nxënësve është 21–40.

iv. Klasa të veçanta, kur numri i nxënësve i të gjitha klasave VI–IX është mbi 40, pavarësisht nga numri i nxënësve për klasë.

v. Në klasat bashkuara, kur ka më shumë se 10 nxënës, mësimi zhvillohet i ndarë vetëm për lëndët Gjuhë shqipe, Gjuhë e huaj dhe Matematikë.

vi. Në klasat I–IX të pakicave kombëtare mësimi zhvillohet në klasa të veçanta, pavarësisht numrit të nxënësve për klasë.

vii. Në shkollat speciale klasat e bashkuara formohen për çdo nivel sipas këtij rregulli: një klasë me deri 5 nxënës; dy klasa me 6–10 nxënës; tri klasa me 11–15 nxënës.

viii. Në shkollat speciale formohen klasa të veçanta kur në arsimin fillor apo të mesëm të ulët ka mbi 15 nxënës.

3. Numri i drejtuesve

a) Kur numri i nxënësve është më shumë se 80, emërohet një drejtor shkolle.

b) Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkolle.

c) Kur numri i nxënësve është 481–800, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.

d) Kur numri i nxënësve është mbi 800, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

e) Kur numri i nxënësve është mbi 150 dhe drejtorja ka në vartësi 4 shkolla, emërohet një nëndrejtor.

Kur numri i nxënësve të një shkolle vartëse është më pak se 80 dhe aty punojnë të paktën 4 mësues, caktohet një kryemësues.

Numri i nxënësve të kopshteve që zhvillojnë veprimtarinë e tyre pranë shkollave dhe nuk administrohen nga drejtues kopshti, të llogaritet në numrin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës.

f) Në shkollat speciale:

i. emërohen një drejtor dhe një nëndrejtor, kur numri i nxënësve është deri në 130.

ii. emërohen dy nëndrejtorë, kur numri i nxënësve është mbi 130.

4. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve:

a) Edukator në institutet për nxënësit me aftësi të kufizuara: 30 orë në javë.

b) Mësuesi/kryemësuesi në arsimin fillor e kanë normën javore aq orë mësimore sa janë në planin mësimor të klasës ku jep mësim.

c) Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore, mësuesi ndihmës, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë.

d) Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë.

e) Kryemësuesi në arsimin e mesëm të ulët: 20 orë në javë (përgjigjet për disiplinën dhe inventarin e shkollës).

f) Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: 6 orë në javë.

g) Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: 4 orë në javë.

h) Drejtori i shkollës me 601–800 nxënës: 2 orë në javë.

i) Drejtori i shkollës mbi 800 nxënës: 0–2 orë në javë.

j) Nëndrejtori i shkollës: 6 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë.

5. Norma e vlerësimit të arritjeve

a) Drejtori i shkollës me 81–800 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

b) Drejtori i shkollës me mbi 800 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

c) Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

III. ARSIMI MESËM I LARTË, GJIMNAZ

1. Numri i nxënësve për klasë

a) Klasat në zonat urbane të formohen me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.

b) Ndarja e klasave paralele të bëhet sipas këtij rregulli:

i. dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30–59 nxënës;

ii. tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60–99 nxënës;



iii. katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100–133 nxënës;

iv. pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134–167 nxënës.

v. Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele bëhet për çdo rritje të numrit me 33 nxënës.

2. Numri i drejtuesve

a) Kur numri i nxënësve është mbi 80, emërohet një drejtor shkolle.

b) Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkolle.

c) Kur numri i nxënësve është 481–800, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.

d) Kur numri i nxënësve është mbi 800, emërohen tre nëndrejtorë shkolle.

3. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

a) Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë: 18 orë në javë.

b) Mësuesi i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji), i ekonomisë, mësuesi ndihmës, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë.

c) Mësuesi i lëndëve të tjera: 22 orë në javë.

d) Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: 6 orë në javë.

e) Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: 4 orë në javë.

f) Drejtori i shkollës me 601–800 nxënës: 2 orë në javë.

g) Drejtori i shkollës mbi 800 nxënës: 0-2 orë në javë.

h) Nëndrejtori i shkollës: 6 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, kur shkolla nuk ka sekretar.

4. Norma e vlerësimit të arritjeve

a) Drejtori i shkollës me 81–800 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

b) Drejtori i shkollës me mbi 800 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

c) Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkolle).

IV. ARSIMI I ORIENTUAR

1. Numri i nxënësve për klasë

a) Klasat e veçanta të formohen me jo më pak se 15 nxënës.

b) Ndarja e klasave paralele bëhet sipas këtyre kushteve:

i. dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30–59 nxënës;

ii. tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60–99 nxënës;

iii. katër klasa paralele, kur numri i nxënësve është 100–133 nxënës;

iv. pesë klasa paralele, kur numri i nxënësve është 134–167 nxënës.

v. Ndarja e nxënësve në më shumë se pesë klasa paralele bëhet për çdo rritje të numrit me 33 nxënës.

2. Numri i drejtuesve

a) Kur numri i nxënësve është mbi 80, emërohet një drejtor shkolle.

b) Kur numri i nxënësve është 150–250, emërohet një nëndrejtor.

c) Kur numri i nxënësve është 251–400, emërohen dy nëndrejtorë.

d) Kur numri i nxënësve është mbi 400, emërohen tre nëndrejtorë.

3. Norma mësimore javore e mësuesve dhe e drejtuesve

a) Mësuesi i gjuhës shqipe dhe i letërsisë: 18 orë në javë.

b) Mësuesi i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, i teknologjisë, i shkencave shoqërore (filozofi, psikologji, qytetari, sociologji), i ekonomisë, mësuesi ndihmës: 20 orë në javë.

c) Mësuesi i specialitetit: 22 orë në javë.

d) Dega “Muzikë”:

i. Mësuesit e specialiteteve muzikore: 18 orë në javë.

ii. Mësuesit e specialitetit pianist shoqëruar: 24–26 orë në javë.

iii. Mësuesit e lëndëve teorike muzikore: 18–20 orë në javë.

iv. Grupet e lëndëve teoriko-praktike formohen me 6 nxënës.

e) Dega “Arte figurative”:



i. Mësuesit e specialiteteve: 16–18 orë në javë $(8+8)/(9+9)$.

ii. Mësuesit e lëndëve teorike artistike: 16–18 orë në javë.

iii. Grupet për lëndët pikturë/vizatim: 4–6 nxënës për grup.

iv. Grupet për lëndët skulpturë dhe specialitetet: 3–4 nxënës për grup.

f) Dega “Balet”:

i. Mësuesit e specialiteteve të baletit: 20 orë në javë.

ii. Mësuesit e lëndëve pianist shoqërues dhe piano sekondare: 20 orë në javë.

iii. Lënda e baletit klasik zhvillohet e ndarë vajza/djem, pavarësisht numrit.

g) Drejtori i shkollës me 81–200 nxënës: 8 orë në javë.

h) Drejtori i shkollës me 201–600 nxënës: 6 orë në javë.

i) Drejtori i shkollës me mbi 600 nxënës: nuk jep mësim.

j) Nëndrejtori i shkollës me 201–400 nxënës: 8 orë në javë.

k) Nëndrejtori i shkollës me mbi 400 nxënës: 6 orë në javë.

Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës e plotësojnë normën e tyre mësimore javore vetëm me orë të profilit të diplomës që zotërojnë.

Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, kur shkolla nuk ka sekretar.

4. Norma e vlerësimit të arritjeve

a) Drejtori i shkollës me 81–600 nxënës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).

b) Drejtori i shkollës me mbi 600 nxënës: 3 orë në javë (2 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).

c) Nëndrejtori i shkollës: 4 orë në javë (3 orë për vlerësim të cilësisë së procesit mësimor dhe 1 orë për dokumentacionin shkollor).

5. Organizimi i mësimit në shkollat artistike

a) Orët teorike zhvillohen me të gjithë klasën në lëndët: Harmoni, Analizë e veprave muzikore, Histori e muzikës shqiptare dhe botërore, Folklor muzikor, Literaturë muzikore, Orkestracion, Dëshifrazh, Histori arti, Perspektivë, Anatomi dhe estetikë.

b) Orët praktike zhvillohen në grupe me 4–5 nxënës në lëndët: Harmoni, Analizë e veprave muzikore dhe Orkestracion.

c) Mësimi individual me 1 nxënës zhvillohet në lëndët: Instrumentist, Mjeshtëri e të kënduarit dhe Piano sekondare.

d) Në lëndën muzikë dhome, mësimi zhvillohet në grupe që formohen me 2–5 nxënës. Në varësi të formacionit dhe të programit mësimor mund të krijohen edhe duete.

e) Shoqërimi i instrumentistëve në saxhio: Harqet 8 orë mësimi në vit për nxënës, instrumentet e frymës 6 orë mësimi në vit për nxënës.

f) Në degën e artit figurativ, mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 8 nxënës në lëndët: vizatim, pikturë, plastikë.

g) Në lëndët e specialiteteve të artit figurativ mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 4 nxënës.

6. Organizimi i mësimit në shkollat sportive

a) Orët teorike në lëndët “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Futboll” dhe “Atletikë” zhvillohen me të gjithë klasën.

b) Orët teorike në lëndët “Formim teorik profesional” (FTP) të specialiteteve “Volejbol” dhe “Basketbol” zhvillohen në grupe, të cilat formohen me jo më pak se 7 nxënës.

c) Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) për specialitetin “Futboll” zhvillohen me të gjithë klasën.

d) Orët e lëndës “Formim praktik profesional” (FPP) zhvillohen me grupe, sipas të specialiteteve “Volejbol” dhe “Basketbol”, sipas klasave.

e) Në specialitetet “Peshëngritje” dhe “Atletikë”, sipas disiplinave, mësimi zhvillohet në grupe me jo më pak se 6 nxënës.

f) Lënda “Sport ndihmës” zhvillohet në grupe të ndara, sipas gjinisë djem dhe vajza, sipas klasave.

V. DISPOZITA TË VEÇANTA

1. Ngarkesë mësimore javore është numri i orëve mësimore që i ngarkohet punonjësit arsimor për çdo javë të vitit mësimor. Ngarkesa mësimore javore përfshin orët e mësimit të çdo lënde që përmban plani mësimor dhe çdo orë të përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij. (Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, mësuesi ngarkohet me orë mësimore të profileve të



përafërta, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe pjesë e këtij udhëzimi.)

3. Në arsimin e mesëm të lartë, për shpërndarjen e ngarkesës mësimore sipas profileve dhe për përcaktimin e mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore, drejtoritë e shkollave së pari do të plotësojnë me orë mësimore mësuesit që janë diplomuar në lëndën/profilin që është shkruar i pari në kolonën e profileve të kërkuara, në shtojcën 1.

4. Në shkollat e arsimit bazë, shpërndarja dhe planifikimi i ngarkesës mësimore do të bëhet për të gjitha profilet në mënyrë të njëjtë, pa marrë në konsideratë radhën në të cilën ato janë shkruar në kolonën e profileve të kërkuara në shtojcën 1.

5. Mësuesit që mentoron praktikën profesionale të kandidatëve për mësues, i llogariten dy orë mësimore në javë si orë mbi normë/ngarkesë për periudhën e mentorimit.

6. Mësuesit që përgatit nxënës për fazën e dytë dhe të tretë të olimpiadave, ose për pjesëmarrje në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare, i llogariten dy orë mësimore në javë si orë mbi normë/ngarkesë për periudhën e angazhimit.

7. Të gjitha normat e veçanta, të përcaktuara në këtë kre për efekte financiare kanë vlerën e orës mësimore.

8. Puna e mësuesit kujdestar (mësuesit të klasës) është e barasvlershme me 2 orë mësimore në javë.

9. Masa e pagesës për orën mësimore mbi ngarkesën mësimore javore bëhet sipas tarifave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Çdo orë mësimore e realizuar nga mësuesi mbi ngarkesën mësimore javore të tij paguhet si orë mbi normë, në fund të çdo muaji.

11. Në një shkollë vartëse të arsimit bazë me të paktën 4 mësues, kryemësuesi përgjigjet për disiplinën dhe inventarin e shkollës.

12. Në arsimin fillor, kur klasa e bashkuar ka mbi 10 nxënës, mësuesit/kryemësuesit t'i llogariten dhe t'i paguhet 5 orë mbi normë/ngarkesë për çdo javë mësimi të zhvilluar.

13. Në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë, mësuesi lejohet të ketë orë mbi normë/ngarkesë jo më shumë se 30% të ngarkesës mësimore javore.

14. Mësuesit që drejton bibliotekën e shkollës, i llogariten:

a) 2 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka deri në 300 nxënës;

b) 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 301–600 nxënës;

c) 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.

15. Për zhvillimin e veprimtarive konkrete të programuara në kuadër të shkollës si qendër komunitare llogariten 10 orë në javë, të ndara me jo më shumë se 2 orë për mësues.

16. Mësuesit që drejton rrjetin profesional (në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë), i llogariten 2 orë mësimore në javë.

17. Mësuesit që merret me veprimtaritë artistike dhe mësuesit që kryen detyrën e koordinatorit të qeverisë së nxënësve për shkollat nën 700 nxënës i llogariten secilit 2 orë në javë dhe për shkollat mbi 700 nxënës i llogariten secilit 4 orë në javë.

18. Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” (BDSH), ora e studimit është e barasvlershme me orën mësimore. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në këtë nismë të realizohen jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar. Një mësues mund të plotësojë ngarkesën mësimore javore me jo më shumë se 3 orë studimi BDSH.

19. Mësuesit, në shkollat me më shumë se 700 nxënës që kanë palestër, kur krijojnë dhe stërvitin ekupe sportive, jo më shumë se në dy lloje sporti për femra dhe meshkuj, i ulet ngarkesa mësimore javore me 3 orë në javë.

20. Mësuesit të specialitetit në shkollat sportive, kur stërvit grupet/ekipet sportive të shkollës për pjesëmarrje në takimet sportive (kampionate rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare), sipas kalendarëve sportivë të federatave shqiptare përkatëse, në përmbushje të veprimtarive sportive të parashikuara në kurrikulën sportive, i llogariten si ngarkesë mësimore 3 orë në javë.

21. Mësimi në lëndën e edukimit fizik zhvillohet i ndarë sipas gjinisë dhe, kur është e mundur, mësuesi të jetë i së njëjtës gjini me nxënësit. Ndarja sipas gjinisë bëhet sipas këtij rregulli:

a) Në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë, kur numri i nxënësve për çdo gjini është jo më pak se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik të bëhet i ndarë në gjini.

b) Në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë që kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini në të paktën një paralel, është më i vogël se 10 nxënës, mësimi i edukimit fizik të bëhet i ndarë në gjini, por duke bashkuar dy paralele.



c) Në arsimin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë që nuk kanë klasa paralele, kur numri i nxënësve për çdo gjini është më i vogël se 10, mësimi i edukimit fizik të bëhet pa u ndarë në gjini.

22. Për zhvillimin e praktikës në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, të lëndëve të specialitetit në shkollat koreografike dhe teori solfezhi në shkollat e muzikës, kur klasa ka mbi 20 nxënës, ndahet në dy grupe.

23. Orët për shoqërimin dhe drejtimin e nxënësve (klasës) në praktikat profesionale mësimore të llogariten 1,5 orë praktikë = 1 orë mësimore.

24. Mësuesve që vlerësojnë testet e provimeve kombëtare të arsimit bazë, t'u llogaritet për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

25. Mësuesve që vlerësojnë fazën II të olimpiadave kombëtare të organizuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, t'u llogaritet për efekt pagese 1 orë mësimore për 3 teste të vlerësuara.

26. Nëndrejtorit të ngarkuar për plotësimin e amzës së shkollës, ose si administrator për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, i ulet norma me 2 orë mësimore në javë.

27. Në shkollat që nuk kanë as nëndrejtor, as sekretar, ngarkohet një mësues për plotësimin e amzës së shkollës, si dhe një mësues për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, të cilëve u ulet ngarkesa me 2 orë mësimore në javë.

28. Në klasën e dymbëdhjetë të gjimnazit, lëndët me zgjedhje të zhvillohen në bazë të kërkesave të nxënësve për një lëndë të caktuar.

29. Si rregull, mësuesit të cilëve u është ulur ngarkesa për kryerjen e veprimtarive të ndryshme

të përcaktuara në këtë udhëzim, nuk mund të ngarkohen me orë shtesë të pagueshme, përveç rasteve kur shkolla në bashkëpunim me institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nuk mund t'i mbulojë ato orë me mësues të tjerë.

30. Mësuesit mbikëqyrës të procesit të Maturës Shtetërore i ulet norma me 2 orë mësimore në javë.

31. Mësuesi që në kuadër të Maturës Shtetërore, në gjimnazin e caktuar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, ngarkohet për hedhjen e notave të të gjitha viteve të kandidatëve me diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë shtetit dhe të njësuar në Shqipëri, paguhet jo më shumë se 30 orë mbi normë/ngarkesë në vit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Numri i nxënësve për klasë dhe ngarkesa mësimore e punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar do të jenë si më sipër duke filluar nga viti shkollor 2023–2024.

2. Udhëzimi nr. 30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

SHTOJCË 1

1. ARSIMI PARASHKOLLOR DHE MËSUESIT SIPAS PROFILIT

Nr.	Grupet	Profili i kërkuar
1	Grupi I, II, III	Bachelor për arsimin parashkollor

2. Arsimi fillor (klasat I–V) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Klasat	Profili i kërkuar
1	Klasat I, II, III, IV, V	Arsimi i lartë për arsim fillor

3. Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI–IX) dhe mësuesit sipas profilit

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe-letërsi	



2	Gjuhë e huaj	Gjuhë e huaj	
3	Matematikë	Matematikë, Matematikë-fizikë	Fizikë
4	Fizikë	Fizikë, Matematikë-Fizikë	Matematikë
5	Kimi	Kimi, Biologji-kimi	Biologji
6	Biologji	Biologji, Biologji-kimi	Kimi
7	Histori	Histori, Histori-gjeografi	Gjeografi
8	Gjeografi	Gjeografi, Histori-gjeografi	Histori,
9	Qytetari	Shkenca sociale	Histori-gjeografi, Histori, Gjeografi, Gjuhë shqipe-Letërsi
10	Art pamor	Arte figurative	
11	Muzikë	Arte muzikore	
12	Kërcim	Arti skenik (koreografi)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë), ose edukim fizik.
13	Teatër	Arti skenik (aktrim, regji)	Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose gjuhë shqipe
12	Aftësim teknologjik	Shkencat e natyrës, TIK	Shkencat e natyrës, Informatikë
13	Edukim fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	
14	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë, Fizikë Matematikë-Fizikë

4. Arsimi i mesëm i lartë dhe mësuesit sipas profilit

a) Kurrikula bërthamë

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
3	Gjuhë e huaj e parë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
4	Matematikë	Matematikë, Matematikë-Fizikë	Fizikë
5	Fizikë	Fizikë, Matematikë-Fizikë	Matematikë
6	Kimi	Kimi, Biologji-kimi	
7	Biologji	Biologji, Biologji-kimi	
8	Histori	Histori, Histori-gjeografi	gjeografi
9	Gjeografi	Gjeografi, Histori-gjeografi	Histori
10	Qytetari	Shkenca Sociale	Histori-gjeografi
11	Filozofi	Shkenca Sociale	Filozofi
12	Ekonomi	Shkenca Sociale	Ekonomi
13	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë
14	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	

b) Kurrikula me zgjedhje

Nr.	Lëndët	Profili i kërkuar	Profili i përafërt
1	Letërsi	Gjuhë shqipe dhe letërsi	
2	Gjuhë e huaj e dytë	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...)	
3	Fizikë	Fizikë, matematikë-Fizikë	Matematikë
4	Kimi	Kimi	Biokimi
5	Biologji	Biologji, Biologji-kimi	Kimi
6	Histori	Histori, Histori-gjeografi	Gjeografi
7	Gjeografi	Gjeografi, Histori-gjeografi	Histori
8	Psikologji	Shkenca sociale	Filozofi, Histori-gjeografi



9	Sociologji	Shkenca sociale	Filozofi, Histori-gjeografi
10	Teknologji	TIK, Fizikë	Shkencat e natyrës, Informatikë, Inxhinieri
11	TIK	Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë	Matematikë, fizikë
12	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	Edukim fizik	
13	Arte	Arti skenik, Muzikë, Art figurativ	Gjuhë shqipe dhe letërsi

URDHËR**Nr. 385, datë 29.6.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z.Arjan Jaupllari.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për çështjet e përcaktuara në këtë urdhër, do të ushtrohen në datat 3 dhe 4 korrik 2023.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR**Nr. 399, datë 6.7.2023**

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMIT
GFCM/45/2022/11, “MBI STANDARDET
MINIMALE PËR MENAXHIMIN E
ZONAVE TË KUFIZUARA
TË PESHKIMIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3 të Marrëveshjes, “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003; të nenit 12, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit GFCM/45/2022/11, “Mbi standardet minimale për menaxhimin e zonave të kufizuara të peshkimit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.



2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIMI GFCM/45/2022/11
MBI STANDARDET MINIMALE PËR
MENAXHIMIN E ZONAVE TË
KUFIZUARA TË PESHKIMIT

Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM/KPPM):

duke rikujtuar se objektivi i Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (“Marrëveshja KPPM”) është të sigurojë ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm, në nivel biologjik, social, ekonomik dhe mjedisor, të burimeve të gjalla detare në zonën e aplikimit të KPPM-së;

duke vënë në dukje se objektivi 14.5 i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm (SDG) që kërkon në mënyrë specifike ruajtjen dhe mbrojtjen e të paktën 10% të zonave bregdetare dhe detare, në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar;

duke theksuar angazhimin sipas nenit 8 të Marrëveshjes KPPM-së për të minimizuar ndikimet e aktiviteteve të peshkimit në burimet e gjalla detare dhe ekosistemet e tyre dhe për të krijuar Zona të Kufizuara të Peshkimit (ZKP) për mbrojtjen e Ekosistemeve Detare të Cënueshme (VME/EDC), duke përfshirë, por, gjithashtu, moskufizimin e zonave për mbarëshkrimin e vezëve;

duke rikujtuar Deklaratën Ministrore të Maltës MedFish4Ever 2017 dhe, në veçanti, paragrafin 38 të saj mbi zhvillimin e zonave të mbrojtura detare dhe zonat e kufizuara të peshkimit që sigurojnë një mbrojtje efektive për të paktën 10% të Detit Mesdhe deri në vitin 2020, e cila është në përputhje me Objektivin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm 14.5;

më tej, duke marrë parasysh se sipas Kodit të Sjelljes së FAO-s për Peshkimin e Përgjegjshëm, shtetet duhet të zbatojnë gjerësisht qasjen paraprake për

ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve të gjalla ujore, me qëllim mbrojtjen e tyre dhe ruajtjen e mjedisit ujor, duke marrë parasysh provat më të mira shkencore në dispozicion dhe se mungesa e informacionit adekuat shkencor nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen ose mosmarrjen e masave të ruajtjes dhe të menaxhimit;

duke theksuar nevojën për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave shkencore, në lidhje me habitatet e ndjeshme, habitatet thelbësore të peshqve dhe të gjitha burimet e vdekshmërisë për speciet kryesore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të dhënat nga peshkimi brenda zonës së aplikimit të marrëveshjes KPPM;

duke marrë parasysh miratimin e një strategjie të re të KPPM-së (2021–2030) drejt qëndrueshmërisë së peshkimit në Mesdhe dhe në Detin e Zi dhe duke synuar, veçanërisht, “promovimin e identifikimit dhe krijimin e ZKP-ve të reja për të mbrojtur zonat prioritare ekologjike ose biologjike, EDC etj.”, brenda zonave detare të rëndësishme nga aktivitetet e dëmshme të peshkimit dhe zbatimin e sistemeve të monitorimit dhe të kontrollit për të siguruar efikasitetin e këtyre masave hapësinore;

më tej, duke marrë parasysh objektivat sipas rezolutës GFCM/41/2017/5 për një rrjet të habitateve thelbësore të peshkut në zonën e aplikimit të KPPM-së, rezoluta GFCM/43/2019/1 për hartimin e masave të zbatueshme për ZKP-të në zonën e aplikimit të KPPM-së dhe rezoluta GFCM/43/2019/3 për zbatimin e një sistemi monitorimi për anijet dhe ditari elektronik në zonën e aplikimit të KPPM-së (VMS dhe ERS);

duke rikujtuar se përcaktimi dhe evolucioni i çdo ZKP-je kërkon të jetë i bazuar në shkencë dhe i përgatitur me të gjitha palët e interesuara, si peshkatarët, shkencëtarët, administratat lokale, OJQ-të mjedisore;

duke marrë parasysh Këshillën e Komitetit Këshillimor Shkencor për Peshkimin (SAC/KKSHP) dhe Komitetit të Përputhshmërisë (CoC/KP), të shprehura më 2019, më 2021 dhe më 2022, për vendosjen e standardeve minimale në ruajtjen, monitorimin dhe kontrollin në ZKP,

miraton, në përputhje me nenet 5(b), 8(b) dhe 13 të Marrëveshjes KPPM, rekomandimin e mëposhtëm.



KREU I
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM,
QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Objektivi i përgjithshëm

1. Ky rekomandim përcakton standardet minimale për Zonat e Kufizuara të Peshkimit (ZKP) të përcaktuara me anë të vendimeve të KPPM-së, me qëllim rritjen e koherencës së rrjetit të KPPM-së për ZKP-të, harmonizimin e masave të menaxhimit, të zbatueshme në të gjitha nënzonat, rritjen e kushteve të barabarta midis peshkatarëve dhe përmirësimin e statusit të ruajtjes së rezervave dhe ekosistemeve.

Fushëveprimi

2. Ky rekomandim zbatohet për të gjitha ZKP-të e krijuara nga vendimet e KPPM-së. ZKP-të e krijuara pas hyrjes në fuqi të këtij rekomandimi do të jenë në përputhje me dispozitat e këtij rekomandimi. ZKP-të e krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij rekomandimi mund të vlerësohen nga KKSHP-ja dhe nëse shihet e nevojshme, të rishikohen sipas dispozitave të këtij rekomandimi.

Përkufizimet

3. Për qëllime të këtij rekomandimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Zonë e kufizuar e peshkimit” (ZKP) nënkupton një zonë të përcaktuar gjeografikisht në të cilën disa aktivitete specifike peshkimi ndalohen ose kufizohen përkohësisht për të përmirësuar ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare në zonën e aplikimit të KPPM-së;

b) “Habitat thelbësor i peshkut” nënkupton habitatet e identifikuar si thelbësore për kërkesat ekologjike dhe biologjike për fazat kritike të historisë së jetës së specieve të shfrytëzuara të peshkut dhe që mund të kërkojnë mbrojtje të veçantë për të përmirësuar statusin e stoqeve dhe qëndrueshmërinë afatgjatë;

c) “Autorizim peshkimi” nënkupton të drejtën e një anijeje peshkimi, e ndryshme nga licenca e peshkimit dhe e lëshuar nga Palët Kontraktuese për t’u përfshirë në aktivitete peshkimi me mjete peshkimi të veçanta, gjatë një periudhe të caktuar

dhe në një zonë të caktuar ose për një peshkim të caktuar në kushte specifike;

ç) “Peshkimi i paligjshëm”, i paraportuar dhe i parregulluar ose “peshkimi PPP” nënkupton aktivitetet e përshkruara në paragrafin 3 të Planit Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s të vitit 2001 për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (IPOA-IUU) dhe në vijim dispozitat e Rekomandimit KPPM/41/2017/7;

d) “Ditë peshkimi”, nënkupton çdo periudhë të vazhdueshme prej 24 orësh, ose një pjesë të saj, gjatë së cilës një anije është duke kërkuar për peshk, guajtje, vendosje, tërheqje, tërheqje të një pajisjeje peshkimi, marrjen e zënieve në bord, transbordimin, mbajtjen në bord, përpunimin në bord, transferimin dhe zbarkimin e peshkut dhe të produkteve të peshkimit;

dh) “Aktivitete peshkimi rekreativ” do të thotë peshkim jo për qëllime tregtare që shfrytëzon burimet biologjike detare për rekreacion, turizëm ose sport.

KREU II
MASAT E MENAXHIMIT

4. Me qëllim menaxhimit dhe mbrojtjes e ZKP-ve nga ndikimi i çdo aktiviteti që rrezikon ruajtjen e veçorive që karakterizojnë habitatet e mbrojtura nga një ZKP, aktivitetet e peshkimit në ZKP do të monitorohen nga Palët Kontraktuese, në ujërat nën juridiksionin e tyre dhe/ose sovraniteti për t’i ofruar çdo vit KPPM-të një listë të anijeve të autorizuar të peshkimit, me kapacitetet përkatëse, dhe çdo parametër të mëtejshëm të listuar si të rëndësishëm nga KKSHP-ja.

5. Bazuar në vlerësimin e KKSHP-së, krijimi i një ZKP-je të re në përgjithësi duhet të përmbajë dy lloje zonash me masa specifike menaxhimi, të diskutuara me palët e interesuara:

Zona A – Mbyllje e përhershme

6. Çdo aktivitet i peshkimit profesional i lidhur me objektivat specifike të ZKP-së do të ndalohet.

7. Ndalohet çdo aktivitet peshkimi rekreativ.

8. Anijet e peshkimit që kalojnë tranzit duhet të kenë në bord një pajisje operative për sistemet e monitorimit të anijeve (VMS) dhe/ose sistemet e identifikimit të automatizuar (AIS), që shfaq transmetimin e rritur të të dhënave dhe të gjitha



pajisjet e peshkimit të shtrënguara dhe të vendosura gjatë gjithë kohëzgjatjes së tranzitit. Anijet profesionale të peshkimit në përputhje me rekomandimin e KPPM-së duhet të ndjekin një kurs të drejtpërdrejtë me një shpejtësi konstante jo më pak se 6 nyja, me përjashtim të rasteve të forcës madhore ose kushteve të pafavorshme. Në raste të tilla, kapiteni duhet të informojë menjëherë qendrën e monitorimit të peshkimit të shtetit flamur të anijes, në mënyrë që ata të mund të njoftojnë për forcën madhore autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Zona B – Mbyllje e përkohshme

9. Aktivitetet e peshkimit do të ndalohen për të paktën dy muaj çdo vit. Periudha dymujore do të vlerësohet nga KKSHP-ja.

10. Palët Kontraktuese krijojnë një regjistër të anijeve të peshkimit të autorizuar për të peshkuar në këtë zonë.

KREU III

MBLEDHJA, MONITORIMI DHE STUDIMI I TË DHËNAVE

11. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që:

a) një plan monitorimi shkencor për çdo ZKP është duke u zhvilluar nga Palët Kontraktuese, duke ndjekur protokollin KPPM të miratuar në sesionin e 23-të të KKSHP-së, që përfshin një paketë mjetesh ZKP (aneksi 1 i shtojcës 13) dhe udhëzime të integruara për zhvillimin e planeve të monitorimit shkencor (shtojca 2 e shtojcës 13), dhe e vërtetuar nga KKSHP-ja për të dhënë një përmbledhje për mbledhjen e informacionit të kërkuar për të vlerësuar efektivitetin e ZKP-së drejt rindërtimit të rezervave, mbrojtjes së habitateve dhe ekosistemeve detare të cenueshme dhe drejt rritjes së dendësisë së organizmave, për sa i përket biomasës dhe bollëkut brenda ZKP-së. Rezultatet e një plani monitorues të ZKP-së duhet të raportohen rregullisht dhe të diskutohen brenda organeve përkatëse ndihmëse të KKSHP-së. Plan i monitorimit dhe efikasiteti i tij duhet të vlerësohen rregullisht nga KKSHP-ja;

b) informacioni për të gjitha anijet e autorizuar për të peshkuar në zonën B të ZKP-së regjistrohet nga Palët Kontraktuese (siç renditet në aneksin 1) dhe bëhet i disponueshëm publikisht në faqen e internetit të KPPM-së;

c) informacioni mbi aktivitetet e peshkimit, të dhënat e peshkimit të specieve kryesore, zëniet e rastësishme, lrimi dhe/ose hedhja e specieve të ndjeshme të listuar në aneksin 2 ose shtojcën 3 të protokollit SPA/BD regjistrohet nga pronari i anijes në ditarin elektronik ose në një dokument ekuivalent, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e raportimit të të dhënave të rekomandimeve përkatëse të KPPM-së;

ç) një informacion i tillë u raportohet autoriteteve kombëtare për njoftim te Sekretariati i KPPM-së, në kuadër të raportimit të tyre kombëtar vjetor në KKSHP, në përputhje me manualin e DCRF-së;

d) çdo masë tjetër shtesë, si p.sh. mbulimi 5% i vëzhguesve në bord ose monitorimi elektronik në distancë për kushte të barabarta ndërmjet të gjitha anijeve, është marrë për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave në funksion të monitorimit shkencor të specieve kryesore.

12. Sipas rastit, KPPM-ja do të angazhohet në përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitete të tjera bashkëpunuese kërkimore për të përmirësuar njohuritë mbi speciet e ndjeshme, EDC dhe habitatet thelbësore të peshqve dhe për të mbështetur zbatimin efektiv të këtij rekomandimi, duke përfshirë hyrjen në marrëveshje bashkëpunimi me të tjera institucione ndërkombëtare përkatëse.

KREU IV

MASAT E KONTROLLIT DHE TË RAPORTIMIT

13. Palët Kontraktuese do të sigurojnë që të ndërmerren të gjitha mjetet drejt përpunshmërisë së plotë me monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen si aspektet më themelore për të garantuar efektivitetin e ZKP-së, në lidhje me objektivat e saj parësorë të ruajtjes.

14. Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë Sekretariatit të KPPM-së listën e anijeve të autorizuar për zonën B të çdo ZKP-je në fjalë, jo më vonë se 30 prilli i çdo viti, si lista e anijeve të autorizuar për vitin e ardhshëm. Për çdo anije, lista do të përmbajë informacionin e detajuar në aneksin 1.

15. Sekretariati i KPPM-së do të mbajë dhe do të përditësojë listën e anijeve të peshkimit të autorizuar për të peshkuar për speciet kryesore



dhe do ta publikojë atë në faqen e internetit të KPPM-së, në një mënyrë që është në përputhje me politikën dhe procedurat e konfidencialitetit të të dhënave të KPPM-së.

16. Palët Kontraktuese do t'i dërgojnë Sekretariatit të KPPM-së, brenda datës 31 maj të çdo viti, një raport mbi masat e menaxhimit të marra në ZKP-të nga Palët Kontraktuese. Për të lehtësuar një qasje të përbashkët në të gjithë fushën e aplikimit të KPPM-së, ai raport do të përgatitet në përputhje me udhëzimet e përbashkëta të zhvilluara nga Sekretariati i KPPM-së. Raporti do të publikohet në faqen e internetit të KPPM-së brenda dy muajve pas marrjes, duke siguruar që të dhënat personale të mbrohen në përputhje me rregullat e KPPM-së.

17. Raporti do të përmbajë masat e ruajtjes, kontrollit dhe menaxhimit, listën e anijeve të autorizuar dhe informacionin përkatës mbi autorizimet në ZKP dhe listën e shkeljeve të zbuluara çdo vit të kryera jashtë zonave nën sovranitetin e Palëve Kontraktuese (lloji i shkeljes, sanksioni i aplikuar etj.). Raporti do të kërkojë të identifikojë aktivitetet (p.sh. peshkimi, lundrimi) në ZKP.

18. Për anijet dhe pronarët e anijeve me shkelje të identifikuar, Palët Kontraktuese do të përgatisin dhe përfshijnë në raportin e tyre një plan veprimi për të përforcuar monitorimin e anijeve që mbajnë flamurin e tyre që zhvillojnë aktivitet në brendësi të ZKP-së.

19. Nëse është e nevojshme, do të krijohet një grup pune i dedikuar KPPM-së, për Zonat e Kufizuara të Peshkimit (GPZKP) për të vlerësuar raportet e Palëve Kontraktuese dhe planet e tyre të veprimit. GPZKP-ja do të përgatisë një raport për KKSHP-në dhe Komitetin e Përputhshmërisë (KP) që do të vlerësojë dhe do të këshillojë KPPM-në për menaxhimin dhe zbatimin e masave të marra nga Palët Kontraktuese.

20. Në përputhje me rekomandimet e KPPM-së, anijet e peshkimit të autorizuar për të peshkuar në zonën B do të pajisen me monitorim elektronik në distancë që shfaq frekuencën e rritur të transmetimit të të dhënave, me ditar elektronik në gjendje të rregullt pune. Pajisjet e peshkimit në bord ose në përdorim duhet të identifikohen siç duhet dhe duhen numëruar dhe shënuar përpara se të fillohet ndonjë operacion peshkimi ose lundrim në KPPM.

21. Për atë sa është e mundur, frekuenca e transmetimit të të dhënave të monitorimit të anijeve (VMS ose AIS) duhet të jetë të paktën një herë në 30 minuta kur një anije peshkimi hyn në çdo zonë të një ZKP-je.

22. Çdo vit, KP-ja do të vlerësojë zbatimin e këtij rekomandimi dhe do të propozojë çdo masë korrigjuese për të përmirësuar përputhshmërinë. Peshkimi në zona dhe periudha të ndaluara do të konsiderohet shkelje e rëndë (peshkimi "PPP"). Shteti i flamurit siguron që anija që kryen këtë shkelje të rëndë të ndërpresë menjëherë aktivitetet e saj të peshkimit dhe të kthehet në port për hetim.

KREU V RAJONIZIMI

23. Që nga viti 2023, KPPM-ja do të miratojë rekomandime specifike të bazuara në këshillat e KKSHP-së, me qëllim zbatimin e parimeve të këtij rekomandimi në secilën nënfushë të mëposhtme:

- a) Deti Mesdhe Perëndimor;
- b) Deti Mesdhe Qendror;
- c) Deti Adriatik;
- ç) Deti Mesdhe Lindor;
- d) Deti i Zi.

KREU VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

24. Palët Kontraktuese do të tërheqin vëmendjen e autoriteteve përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare për të mbrojtur çdo ZKP dhe dy zonat e saj A dhe B nga ndikimi i çdo aktiviteti që mund të rrezikojë ruajtjen e tipareve karakteristike të këtyre habitateve të veçanta.

25. Ky rekomandim nuk do të paragjykojë miratimin e masave më të rrepta nga ana e Palëve Kontraktuese për anijet që mbajnë flamurin e tyre.

26. KKSHP-ja dhe KP-ja do të rishikojnë zbatimin e këtij rekomandimi çdo vit në mënyrë që të nxjerrin rekomandime aty ku është e nevojshme. Këshillat e KKSHP-së do të marrin parasysh specifikat e peshkimit komercial dhe rekreativ në secilën nënzonë të listuar në paragrafin 23. Bazuar në këshillën e KKSHP-së, standardet minimale të masave të menaxhimit për ZKP-të do të rishikohen në vitin 2031.



SHTOJCA I

Lista e përmendur në kreun III do të përmbajë për çdo anije dhe për çdo ZKP informacionin e mëposhtëm:

- Emri i anijes (nëse ka): emri i anijes (me germa latine);
- Numri i regjistrimit kombëtar: kodi që përfaqëson identifikuesin zyrtar të anijes, siç raportohet në regjistrin kombëtar të flotës (vargu alfanumerik);
- Numri i regjistrimit të KPPM-së (kodi ISO 3-alfa i vendit + 9 shifra, p.sh. xxx000000001);
- Numri IMO ose numri i jashtëm i markimit;
- Autoriteti i regjistrimit: emri i autoritetit që ka lëshuar regjistrimin e anijes;
- Emri i Zonës së Kufizuar të Peshkimit;
- Emri i mëparshëm (nëse ka);
- Flamuri i mëparshëm (nëse ka);
- Detajet e mëparshme të fshirjes nga regjistrat e tjerë (nëse ka);
- Sinjali i thirrjes ndërkombëtare të radios (nëse ka);
- Lloji i anijes, gjatësia e përgjithshme (LOA) dhe tonazhi bruto (GT);
- Pajisjet kryesore që përdoren për të peshkuar në zonën B të ZKP-së;
- Llojet e synuara;
- Periudha e autorizuar për peshkim në ZKP: Periudha e autorizuar për peshkim në Zonën e Kufizuar të Peshkimit (ZKP): nga DD.MM.YYYY deri në DD.MM.YYYY dhe pajisjet përkatëse;
- Numri i ditëve të peshkimit që mund të ushtrohet nga çdo anije;
- Numri i ditëve të peshkimit të operuara nga anija në zonën B, të Zonës së Kufizuar të Peshkimit gjatë vitit.

URDHËR

Nr. 447, datë 10.7.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PËRGJITHSHËM TË PËRMBARUESVE
GJYQËSORË TË SHËRBIMIT
PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin

e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 11, pika 1, të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror”,

URDHËROJ:

1. Numri i përgjithshëm i përmbarruesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, të jetë 144 (njëqind e dyzet e katër).
 2. Përfundimisht, për vitin 2023, numri i përgjithshëm i përmbarruesve gjyqësorë të Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror të jetë 78 (shtatëdhjetë e tetë).
 3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 4. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e masave të nevojshme për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në urdhrin e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 739, datë 15.12.2022, “Për miratimin e rregullores ‘Për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë’”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 11.1.2023, bëhet korrigjimi në si më poshtë vijon:

Neni 33 nga pika 3 deri në pikën 14 ishte:

“3. Për moszbatim të shkronjës “r” të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Vërejtje”.

4. Për moszbatim të shkronjave “b”, “e”, “f” “h”, “i”, “j”, “m”, “n”, “o” dhe “p” të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

5. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d”, “k”, “g”, “l” dhe “q” të pikës 2, të nenit 21, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.



6. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “l”, “m”, “n”, “o”, “p”, “q” dhe “r” të pikës 4, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorit të provimit, merret masa “Vërejtje”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

7. Për moszbatim të shkronjave “a”, “j”, “k”, dhe “s” të pikës 4 të nenit 22 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të provimit, masa “Largim nga puna” në rastin e mësuesve, masa të cilat pasqyrohen në librezën e punës.

8. Për moszbatim të shkronjës “f”, “h” të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Vërejtje”.

9. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c”, “e”, dhe “g” të pikës 2, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

10. Për moszbatim të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 23 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Largim nga puna”.

11. Për moszbatim të shkronjave “e”, “g” dhe “h”, të pikës 2, të nenit 24 të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Vërejtje”.

12. Për moszbatim të shkronjës “d”, “f” të pikës 2, të nenit 24 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

13. Për moszbatim të shkronjave “c”, dhe “i” të pikës 2 të nenit 24 të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

14. Për moszbatim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 21, pikave 2 dhe 3 të nenit 22, shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 23 dhe shkronjës “b”, të nenit 24, ndaj drejtorit të zyrës arsimore vendore merret masa “Largim nga detyra”, nga titullari përkatës. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.”.

Neni 33 nga pika 3 deri në pikën 14 bëhet:

“3. “Për moszbatim të shkronjës “q” të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Vërejtje”.

4. Për moszbatim të shkronjave “b”, “e”, “f” “h”, “i”, “j”, “m”, “n” dhe “o”, të pikës 2 të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

5. Për moszbatim të shkronjave “c”, “d”, “k”, “g”, “l” dhe “p”, të pikës 2, të nenit 21 të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të administrimit të provimit, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.

6. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “l”, “m”, “n”, “o”, “p”, “q” dhe “r” të pikës 2 të nenit 22 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorit të provimit, merret masa “Vërejtje”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

7. Për moszbatim të shkronjave “a”, “j”, “k” dhe “s” të pikës 2, të nenit 22, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të provimit, masa “Largim nga puna” në rastin e mësuesve, masa të cilat pasqyrohen në librezën e punës.

8. Për moszbatim të shkronjave “f” dhe “g” të pikës 3, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Vërejtje”.

9. Për moszbatim të shkronjave “b”, “d”, “e” dhe “g” të pikës 3 të nenit 23 të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

10. Për moszbatim të shkronjës “c” të pikës 3, të nenit 23, të kësaj rregulloreje, ndaj administratorëve të sekretimit, merret masa “Largim nga puna”.

11. Për moszbatim të shkronjave “d”, “f” dhe “g” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Vërejtje”.

12. Për moszbatim të shkronjës “e” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje, ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Paralajmërim për largim nga puna”. Kjo masë depozitohet në dosjen personale.

13. Për moszbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “h” të pikës 2, të nenit 24, të kësaj rregulloreje ndaj përgjegjësve të kateve, merret masa “Largim nga puna”. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.



14. Për moszbatim të pikës 3 të nenit 21, pikës 1 dhe 3 të nenit 22, të pikës 1 të nenit 23 dhe shkronjës “b” të, pikës 2, të nenit 24, ndaj drejtorit të zyrës arsimore vendore merret masa “Largim nga detyra”, nga titullari përkatës. Kjo masë pasqyrohet në librezën e punës së punonjësit.”.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë